

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues gjyqtarja Suzana Çerkini, me sekretaren juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit S.S nga fshati D e Poshtme Komuna P, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.579-4/2011, të datës 26.09.2011, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur me datë 29.06.2017, me praninë e Prokurorit të shtetit Ilaz Beqiri, dhe të pandehurit S.S me mbrojtësin e caktuar sipas detyrës zyrtare av.P.H, po të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri S.S, i biri i Rr dhe nënës Z, e vajzërisë B, i lindur me *data e lindjes*, në fshatin D e Poshtme Komuna P, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore, pensioner, i martuar babë i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me letërnjoftim RKS me nr.personal *numer personal*,

Komfor nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP, ndaj të pandehurit S.S,

REFUZOHET AKUZA

Sepse, që nga viti 1999 e deri më 24.07.2011, në shtëpinë e tij në fshatin D Komuna P, ka mbajtur në pronësi pushkën automatike të markës “AK-47”, ngjyrë e zezë në të kaftë, me numër serik 11060753, pa leje valide për mbajtjen e autorizuar të saj, me të cilën rreth orës 19:00, në oborrin e shtëpisë së tij, me rastin e një ahengu familjar-dasme, nga disponimi ka shtënë disa herë në ajër, e cila armë së bashku me karikatorin i është sekuestruar nga patrulla policore pasi kanë shkuar në vendin e ngjarjes, e pasi i pandehuri vullnetarisht ua ka dorëzuar,

- me çka kishte për të kryer veprë penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK,
- Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza,
- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës,

KONFISKOHET një pushkë automatike AK-47, ngjyrë e zezë në të kaftë, me numër serik 11060753, si dhe një karikator ngjyrë e zezë, të precizuara në Listën e provave materiale, Nr.2011-AF-1010, të datës 24.07.2011,

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda me Aktakuzën PP.nr.579-4/2011 të datës 26.09.2011, ka akuzuar S.S për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK dhe, ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale, sipas aktakuzës së lartshënuar, të pakonfirmuar, me datë 29.06.2017 mbajti seancë të shqyrtimit fillestar, në të cilin prokurori i shtetit i ftuar nga gjykata për të lexuar aktakuzën theksoi se, tërhiqet nga aktakuza, përkatësisht nga ndjekja e mëtejme penale ndaj të pandehurit S.S, në drejtim të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK.

Kjo, për arsye se, siç potencon prokurori i shtetit, në veprimet e të pandehurit nuk manifestohen elementet e veprës penale që i vihet në barrë, por manifestohen elementet e veprës penale Mbajtja në pronësi, kontrollë, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK, meqë i pandehuri armën e ka përdorur pa qëllim frikësimi apo kërcënimi, ndërsa kryesit e veprës penale nga neni 328 par.2 të KPK janë amnistuar me Ligjin për Amnistinë Nr.04 L-2009 (në fuqi me datë 04.10.2013) nëse vepra penale është kryer deri më 20.06.2013, andaj propozon gjykatës që të merr aktgjykim refuzues, ndërsa arma t'i konfiskohet.

Gjykata, pas tërheqjes së prokurorit të shtetit nga aktakuza, përkatësisht nga ndjekja e mëtejme penale ndaj të pandehurit S.S, këtë çështje penale e konsideroi si të përfunduar dhe në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP, e refuzoi akuzën dhe mori aktgjykim refuzues.

Vendimin për konfiskimin e sendit, të armës dhe gjësendeve të tjera, të mbajtura, përkatësisht të përdorura në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 60 të KPK lidhur me nenin 328 par.5 të KPK.

Vendimin për lirimin nga shpenzimet gjyqësore, gjykata e mori në bazë të nenit 454 par.1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.518/13, me datë 29.06.2017**

**Sekretarja juridike,
Ardita Azemi**

**Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja,
Suzana Çerkini**

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.